# KUSHTETUTA JONË

Provinca e qytetit të Milanos, me rastin e 60 vjetorit të Republikës ka vendosur të botojë tekstin e plotë të Kushtetutës Italiane të përkthyer në katërmbëdhjetë gjuhë. Përkthimi dhe leximi i këtij teksti mund të luajnë një rol të rëndësishëm dhe të ndihmojnë në prezantimin e rregullave demokratike të Republikës Italiane për të gjithë personat me prejardhje nga vende të huaja, të cilët mbërrijnë në Itali të shtyrë nga nevoja për të gjetur punë, të detyruar nga rrethana të këqija dhe shpesh herë nga gjendja e vështirë ose dramatike në të cilën jetojnë.

Qëllimi, kuptohet atëherë kur është e mundur, është që të bashkëpunohet për të krijuar një ambient mikpritës për emigrantët i cili duhet të jetë edhe në funksion të një politike siguruese ndaj qytetarëve tanë dhe ndaj vetë emigrantëve.

Pjesë themelore e kësaj politike integruese është pranimi i ligjeve tona, i të drejtave dhe detyrimeve që përshkruhen në to duke imagjinuar një të ardhme për emigrantët e shumtë – për disa prej tyre një të tashme – në të cilën ata do të bëhen qytetarë italianë.

Kushtetuta përfaqëson themelin e demokracisë italiane. Ajo u aprovua nga Asambleja kushtetuese në 22 dhjetor të vitit 1947, u shpall në 27 dhjetor të vitit 1947 dhe hyri në fuqi në 1 janar të vitit 1948. Italia, e cila kishte dalë prej më pak se dy vjetësh nga regjimi totalitar fashist dhe nga një luftë shkatërruese, rilindi duke u pajisur me një prej Kartave më të përparuara në botë. Kjo Kartë e ka shoqëruar vendin gjatë fazës së rilindjes dhe transformimit të tij në kombin demokratik dhe mikpritës që është bërë sot, duke përfaqësuar një urë lidhëse midis Evropës kontinentale dhe popujve mesdhetarë.

Në këtë libër përqëndrohet pjesa më e mirë e kulturës politike demokratike italiane, e cila përbën një ndarje rrënjësore e të pakthyeshme me cfarëdo lloj principi autoritar, totalitar dhe obskurantist. Për këtë arsye, Kushtetuta duhet të njihet nga të gjithë, me shpresën që të drejtat dhe detyrimet për të cilat flitet të shndërrohen edhe në pjesë formuese për burrat dhe gratë e imigruar në Itali si dhe në një instrument të rëndësishëm për integrimin e tyre .

Si përfundim, bëhet fjalë për një zgjedhje të përgjegjshme dhe të kujdeshme ndaj problemeve të mëdha të vendit tonë dhe të botës në ditët e sotme.

*Këshilltari për të drejtat e qytetarëve* — *Presidenti*

*Francesca Corso* — *Filippo Penati*

# KUSHTETUTA JONË

Provinca e qytetit të Milanos, me rastin e 60 vjetorit të Republikës ka vendosur të botojë tekstin e plotë të Kushtetutës Italiane të përkthyer në katërmbëdhjetë gjuhë. Përkthimi dhe leximi i këtij teksti mund të luajnë një rol të rëndësishëm dhe të ndihmojnë në prezantimin e rregullave demokratike të Republikës Italiane për të gjithë personat me prejardhje nga vende të huaja, të cilët mbërrijnë në Itali të shtyrë nga nevoja për të gjetur punë, të detyruar nga rrethana të këqija dhe shpesh herë nga gjendja e vështirë ose dramatike në të cilën jetojnë.

Qëllimi, kuptohet atëherë kur është e mundur, është që të bashkëpunohet për të krijuar një ambient mikpritës për emigrantët i cili duhet të jetë edhe në funksion të një politike siguruese ndaj qytetarëve tanë dhe ndaj vetë emigrantëve.

Pjesë themelore e kësaj politike integruese është pranimi i ligjeve tona, i të drejtave dhe detyrimeve që përshkruhen në to duke imagjinuar një të ardhme për emigrantët e shumtë – për disa prej tyre një të tashme – në të cilën ata do të bëhen qytetarë italianë.

Kushtetuta përfaqëson themelin e demokracisë italiane. Ajo u aprovua nga Asambleja kushtetuese në 22 dhjetor të vitit 1947, u shpall në 27 dhjetor të vitit 1947 dhe hyri në fuqi në 1 janar të vitit 1948. Italia, e cila kishte dalë prej më pak se dy vjetësh nga regjimi totalitar fashist dhe nga një luftë shkatërruese, rilindi duke u pajisur me një prej Kartave më të përparuara në botë. Kjo Kartë e ka shoqëruar vendin gjatë fazës së rilindjes dhe transformimit të tij në kombin demokratik dhe mikpritës që është bërë sot, duke përfaqësuar një urë lidhëse midis Evropës kontinentale dhe popujve mesdhetarë.

Në këtë libër përqëndrohet pjesa më e mirë e kulturës politike demokratike italiane, e cila përbën një ndarje rrënjësore e të pakthyeshme me cfarëdo lloj principi autoritar, totalitar dhe obskurantist. Për këtë arsye, Kushtetuta duhet të njihet nga të gjithë, me shpresën që të drejtat dhe detyrimet për të cilat flitet të shndërrohen edhe në pjesë formuese për burrat dhe gratë e imigruar në Itali si dhe në një instrument të rëndësishëm për integrimin e tyre .

Si përfundim, bëhet fjalë për një zgjedhje të përgjegjshme dhe të kujdeshme ndaj problemeve të mëdha të vendit tonë dhe të botës në ditët e sotme.

*Këshilltari për të drejtat e qytetarëve* — *Presidenti*

*Francesca Corso* — *Filippo Penati*

# KUSHTETUTA E REPUBLIKËS ITALIANE

## PARIMET THEMELORE

### Neni 1

Italia është republikë demokratike, e bazuar në punë.
Sovraniteti i përket popullit, dhe ushtrohet nga populli  në format dhe brenda kufijve tëe kushtetutës.

### Neni 2

Republika njeh dhe garanton të drejtat e paceunueshme të njeriut, qoftë si individ, qoftë në grupe shoqërore ku shprehet personaliteti njerëzor dhe kerkon kryerjen e detyrave themelore të solidaritetit politik, ekonomik dhe shoqëror.

### Neni 3

Të gjithë shtetasit kanë dinjitet të njëjtë shoqeror  dhe janë të barabartë para ligjit, pa dallim gjinie, race, gjuhe, feje, mendimi politik, kushtesh personale  e shoqërore.

### Neni 4

Republika ua njeh të drejtën për punë të gjithë qytetarëve dhe krijon kushtet që  e bëjnë efektive këtë drejtë. Çdo qytetar ka për detyrë që, në përputhje me mundësitë  dhe me zgjedhjen personale, të ushtrojë një  aktivitet ose funksion që ndihmon zhvillimin material ose shpirtëror të shoqërisë.

### Neni 5

Republika,  një dhe e pandashme, njeh dhe zhvillon autonomitë lokale dhe zbaton masat administrative më të plota të decentralizimit në ato shërbime qe varen nga shteti. Republika  i përshtat parimet dhe metodat e  legjislacionit të vet  me kërkesat e autonomisë dhe të decentralizimit.

### Neni 6

Republika kujdeset me masa të posacme per minoritetet gjuhësore.

### Neni 7

Shteti dhe kisha katolike, secili në fushën e vet, janë të pavarur dhe sovranë. Marrëdheniet e tyre rregullohen me Paktet  Laterane.
Ndryshimet e Pakteve, të pranuara nga të dyja palët, nuk kërkojnë procedurë për rishikim të kushtetutës.

### Neni 8

Të gjitha besimet fetare janë njësoj të barabarta para ligjit. Besimet fetare, të ndryshme nga besimi katolik, kanë të drejtë të organizohen në përputhje me statutet e veta, për aq sa këto statute nuk janë në kundërshtim me ligjin italian.
Marrëdhëniet e tyre me shtetin rregullohen me ligj mbi bazën e marrëveshjeve ndërmjet shtetit dhe përfaqësuesve përkatës.

### Neni 9

Republika ndihmon zhvillimin e kulturës dhe kërkimin shkencor e teknik.
Ajo mbron mjedisin natyror dhe  trashëgiminë historike e artistike të kombit.

**Neni 10**

Sistemi juridik italian përshtatet me normat e pranuara të së drejtës ndërkombëtare Statusi ligjor i të huajve rregullohet me ligj, në pajtim me normat dhe traktatet ndërkombëtare. Shtetasi i huaj, të cilit, në vendin e vet, i mohohet ushtrimi i vërtetë i i lirive demokratike të garantuara me kushtetutën italiane, ka të drejtë strehimi në territorin e republikës italiane, në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligj. Nuk lejohet ekstradimi i shtetasit të huaj për fyerje politike.

**Neni 11**

Italia e hedh poshtë luftën si instrument cenimi të lirisë së popujve të tjerë dhe i mjet për zgjidhje të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare dhe , në kushte të barabarta me shtetet e tjera, pranon kufuzime të sovranitetit për aq sa janë të nevojshme për një rend botëror që siguron paqe dhe drejtësi ndërmjet kombeve. Italia përkrah dhe inkurajon organizatat ndërkombëtare që kanë këso qëllimesh.

**Neni 12**

Flamuri i Republikës është tringiyrëshi italian: gjelbër, bardh dhe kuq, me tre shirita vertikalë përmasash të barabarta Pjesa e parë.

**Të drejtat dhe detyrat e Shtetasve**

***Kreu I***

***Të drejtat dhe detyrat qytetare***

**Neni 13**

Liria personale është e pacenueshme Nuk lejohet asnjë formë paraburgimi, inspektimi ose bastisjeje personale as ndonjë kufizim tjetër i lirisë së njeriut përveç me urdhër të lëshuar nga autoriteti gjyqësor dhe vetëm në rastet dhe me mënyrat e parashikuara me ligj. Në raste të jashtëzakonshme të domosdoshmërisë dhe në raste urgjente, të përcaktuar qartë me ligj, autoritetet për zbatimin e ligjit mund të marrin masa të përkohshme, për të cilat duhet të njoftohen autoritetet gjyqësore brenda 48 orëve. Nëse këto masa nuk konfirmohen nga autoritetet gjyqësore brenda 48orëve të ardhshme, ato revokohen dhe bëhen të pavlefshmedhe të shfuqizuara. Dënohen të gjitha aktet e dhunës fizike ose morale kundër individëve që në çafarëdo forme u nënshtrohen kufizimeve të lirisë .

Me ligj caktohet periudha kohore maksimale e paraburgimit parandalues.

**Neni 14**

Shtëpia është e pacenueshme. Inspektimet, bastisjet ose konfiskimet nuk mund të bëhen, përveç në rastet dhe me mënyrat e përcaktuara me ligj dhe në përputhje me garancitë e parashikuara për mbrojtjen e lirisë së individit. Kontrollet dhe inspektimet për shkak të shendetit dhe të sigurisë publike ose për qëllime ekonomike efiskale, rregullohen me ligje të posaçme.

**Neni 15**

Liria dhe fshehtesia e korrespondencës dhe e çdo forme tjetër të komunikimit janë të pacenueshme. Kufizimi i tyre mund të bëhet vetëm me urdhër të lëshuar nga një autoritet giyqësor, me garancitë e caktuara me ligj.

**Neni 16**

Çdo shtetas mund të lëvizë e të qëndrojë lirishëm në çdo pjesë të territorit kombëtar, përveç në rast kufizimesh të përgjithshme që i cakton ligji për shkaqe shëndetesore ose sigurie. Asnje kufizim nuk mund të bëhet për arsye politike. Çdo shtetas është i lirë të

dalë nga territori i republikës dhe të kthehet në të, me kusht që të plotësohen të gjitha detyrime ligjore.

**Neni 17**

Shtetasit kanë të drejtë të tubohen paqësisht dhe të paarmatosur Për tubime, madje në edhe vende të hapura publike, nuk kërkohet njoftim paraprak. Për tubime në vende publike duhet të njoftohen paraprakisht autoritetet, të cilat mund t'i ndalojnë ato vetëm për shkaqe të vërtetueshme sigurie ose për shkaqe sigurie publike.

**Neni 18**

Shtetasit kanë të drejtë të formojnë lirshëm shoqata, a autorizim paraprak, për qëllime që nuk u ndalohen individëve me ligjin penal. Ndalohen shoqatat e fshehta dhe ato që ndjekin, qoftë edhe tërthorazi, synime politike nëpërmjet organizimeve të natyrës ushtarake.

**Neni 19**

Të gjithë kanë të drejtë të shprehin lirshëm besimin e vet fetar, në çfarëdo forme, individuale ose në shoqata, ta propagandojnë atë dhe të falen privatisht a publikisht, me kusht që ritet fetare të mos jenë në kundërshtim me moralin shoqëror.

**Neni 20**

Karakteri kishtar dhe qëllimet fetare ose rituale të një shoqate a institucioni nuk mund të jenë shkas për kufizime të posaçme sipas ligjit as për caktimin e tatimit të veçantë për sa i përket themelimit, statusit të tyre ligjor ose aktiviteteve të saj.

**Neni 21**

Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të shprehin lirishëm mendimet e veta, me fjalë, me shkrim dhe me çdo mjet tjetër komunikimi. Shtypi nuk mund t'u nënshtrohet autorizimeve ose censurave. Konfiskimi mund të kryhet vetem me urdhër të lëshuar nga autoriteti giyqësor në rast shkeljes ligjore, për té cilat ligji për shtypin jep autorizim të posaçëm, ose në rastin e shkeljes së normave të veta lidhur me zbulimin e identitetit të atyre që mbajnë përgjegjësi.

Në raste të tilla, kur ka urgjencë të domosdoshme dhe kur nuk është e mundur ndërhyrja me kohë e autoritetit gjyqësor, shtypi periodik mund të sekuestrohet nga oficerë të policisë giyqësore, të cilët menjëherë dhe gjithsesi, brenda 24 orëve, duhet ta lajmërojnë rastin tek autoriteti giyqësor. Nëse ky i fundit nuk e konfirmon urdhrin për sekuestrim brenda 24 orëve në vazhdim sekuestrimi konsiderohet i shfuqizuar dhe i palefshëm.

Ligji mund të vendosë, me norma të karakterit të përgjithshëm që të bëhen publike mjetet financiare të shtypit periodik.

Ndalohen botimet, shfaqjet dhe të gjitha manifestimet e tjera që janë ne kundërshtim me moralin shoqëror. Ligji cakton masat e përshtatshme për parandalimin dhe ndëshkimin e shkeljeve ligjore.

**Neni 22**

Askush nuk mund të mbetet pa kapacitet ligjor, shtetësi ose pa emër për shkaqe politike.

**Neni 23**

Asnjë detyrim me karakter personal ose financiar nuk mund t'i imponohet një individi, përveç me ligj.

**Neni 24**

Të gjithë kanë të drejtë të marrin veprime juridike për t'i mbrojtur të drejtat dheinteresat e tyre tëligjshme.
E drejta për mbrojtje është e pacenueshme në çdo fazë dhe shkallë të proceseve gjyqësore.
Personave indigjenë u sigurohen, me masa të posacme, mjetet për veprime ligjore dhe për mbrojtje në të gjitha nivelet e juridiksionit. Ligji përcakton kushtet dhe mënyrat për përmirësimin e gabimeve gjyqësore.

**Neni 25**

Askujt nuk mund t'i ndryshohet gjyqtari i natyrshëm i caktuar me ligj.
Askush nuk mund të dënohet, përveç në bazë të një ligji që ka hyrë në fuqi para se të jetë kryer vepra.
Askush nuk mund t'u nenshtrohet masave kufizuese përveç në rastet që janë parashikuar me ligj.

**Neni 26**

Ekstradimi i shtetasit lejohet vetem në rastet e parashikuara qartë në konventat ndërkombëtare . Në asnjë rast nuk lejohet ekstradimi për vepra penale politike.

**Neni 27**

Përgjegjësia penale është personale I pandehuri nuk konsiderohet fajtor deri në shpalljen e aktgjykimit përfundimtar. Dënimet nuk mund të përbëjnë trajtime jonjerëzore, por duhet të kenë synim riedukimin e të dënuarit. Nuk lejohet dënimi me vdekje.

**Neni 28**

Sipas ligjeve penale, civile dhe administrative, zyrtarët dhe nëpunësit e shtetit dhe të institucioneve publike janë drejtpërsëdrejti përgjegjës, për veprimet e kryera në shkeljen e të drejtave. Në raste të tilla përgjegjësa civile shtrihet në institucionet shtetërore dhe publike.

***Kreu II***
***Të drejtat dhe detyrat etike dhe shoqërore***

**Neni 29**

Republika njeh të drejtat e familjes si shoqëri natyrore që bazohet në martesë.
Martesa mbështetet në barazinë morale dhe ligjore të bashkëshortëve, brenda kufijve te caktuar me ligj, për garantuar unitetin e familjes.

**Neni 30**

Është detyrë dhe e drejtë e prindërve t'i rritin, arsimojnë dhe edukojnë fëmijët e tyre, madje edhe kur lindin jashtë martesës. Në raste të pamundësisë së prindërve, ligji parashikon si të përmbushen detyrat e tyre Fëmijëve të lindur jashtë martesës ligji u siguron çdo mbrojtje juridike e shoqërore, që përputhet me të drejtat e anëtarëve të familjes së ligjshme.
Ligji përcakton normat dhe kufizimet për përcatimin eatësisë.

**Neni 31**

Republika ndihmon zhvillimin e familjes dhe përmbushjen e detyrave të saj, me kujdes të veçantë për familjet e mëdha, nëpërmjet masave ekonomike dhe ndihmave të tjera.
Ajo mbron nënat, fëmijët dhe të rinjtë, duke zbatuar dispozitat e nevojshme.

**Neni 32**

Republika kjudeset për shëndetin si një e drejtë themelore e individit dhe si një interes i kolektiv dhe garanton përkujdesje mjekësore falas për të varfërit. Askush nuk mund të detyrohet për një trajtim shendetesor, përveç nëse parashihet me dispozita ligjore. Në asnjë rrethanë ligji nuk mund t'i shkelë kufijtë që imponon respekti për njeriun.

**Neni 33**

Republika garanton se arti dhe shkenca mund të mësohen lirshëm Republika cakton rregullat e pergjithshme për arsimin dhe hap shkolla shtetërore për të gjitha degët dhe nivelet.

Institucionet dhe personat privatë kanë të drejtë të hapin shkolla dhe institucione arsimore, pa shpenzime për shtetin ligji Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për shkollat joshtetërore që kërkojne status të barabartë, ligji duhet të sigurojë se këto shkolla gëzojnë liri të plotë dhe se u ofrojnë nxënësve të tyre arsim dhe kualifikime me standarde të njëjta me ato që u ofrohen nxënësve në shkollat shtetërore.

Provimet shtetërore janë paraparë për pranim në shkolla dhe për diplomim në degë të ndryshme dhe në nivele të shkollave, si dhe për kualifikime për të ushtruar një profesion.

Institucionet e arsimit të lartë, universitetet dhe akademitë, kanë të drejtë të vendosin rregulloret e veta, brenda kufijve të përcaktuar me ligjet e shtetit.

**Neni 34**

Shkolla është e hapur për të gjithë. Arsimi i fillor, i cili zhvillohet të paktën për tetë vjet, është i detyrueshëm dhe falas. Nxënësit e aftë dhe ata që e Meritojnë, duke përfshirë edhe ata që nuk kanë mundësi financiare, kanë të drejtë të arrijnë nivelet më të larta të shkollimit.

Republika e bënë këtë të drejtë të efektshme nëpërmjet bursave, shtesave fëminore dhe ndihmave të tjera që do të ndahen nëpërmjet provimeve garuese.

***Kreu III***
***Të drejtat dhe detyrat ekonomike***

**Neni 35**

Republika e mbron punën në të gjitha format e zbatimit të saj, prashikon trajnime dhe.ngritje profesionale të punëtorëve. Ndihmon dhe nxit marrëveshjet dhe organizimet ndërkombëtare që kanë për synim vendosjen dhe rregullimin e të drejtave të punës. Njeh lirinë e imigrimit, sipas detyrimeve të caktuara me ligj në interes të përgjthshëm dhe mbron punëtorët italian jashtë vendit.

**Neni 36**

Punëtorët kanë të drejtë në pagesë, në përpjesëtim me sasinë dhe cilësinë e punës së tyre dhe, në të gjitha rastet, për një shpërblim adekuat që, atyre dhe familjeve të tyre, u siguron një jetë të lirë dhe dinjitoze.

Maksimumi i orëve të punës ditore caktohet me ligj. Punëtorët kanë të drejtë për një pushim javor dhe për pushim vjetor me pagesë nga të cilët nuk mund të heqin dorë.

**Neni 37**

Gratë që punojnë kanë të njëjtat të drejta dhe gëzojnë të drejtën për pagesë të barabartë për punën e njëjtë me burrat. Kushtet e punës duhet t'ua mundësojnë grave ta

përmbushin funksionin e tyre themelor në familje dhe të sigurojnë mbrojtje të përshtatshme për fëmijën dhe nënën.
Ligji cakton kufirin minimal të moshës për punën e paguar. Republika mbron punën e të miturve nëpërmjet dispozitave të posaçme dhe u garanton atyre të drejta për pagesë të barabartë për punën e njëjtë.

**Neni 38**

Çdo shtetas i paaftë për punë dhe pa mjete të nevojshme për të mbijetuar, katë drejtë për ndihmë sociale. Punonjësit kanë të drejtë që t'u sigurohen mjete të mjaftueshme për nevojat e tyre jetësore edhe në rast fatkeqësie, sëmundjeje, invaliditeti, pleqërie papunësie pa dashje. Personat e paaftë dhe ata të hendikepuar kanë të drejtë shkollimi dhe përgatitjeje profesionale. Detyrat e parashtruara në këtë nen janë parashikuar nga organe dhe institucione të themeluara ose të mbështetura nga shteti. Asistenca private mund të jepet lirshëm.

**Neni 39**

Sindikatat kanë të drejtë të organizohen lirshëm. Sindikatave nuk mund t'u caktohet asnjë detyrim, përveç regjistrimit te tyre pranë zyrave lokale a qendrore, në përputhje me dispozitat lijgore Kusht për regjistrim është që statutet e sindikatave të vërtetojnë organizimin e tyre të brendshëm mbi baza demokratike.
Sindikatat e regjistruara kanë statusin e personit juridik. Të përfaqësuara si një trup i vetëm në përpjesetim me anëtarët e tyre, ato mund të nënshkruajnë kontrata kolektive pune të detyrueshme për të gjithë pjesetarët e kategorive te cilëve u referohet kontrata.

**Neni 40**

E drejta për grevë duhet të ushtrohet në përputhje me ligjin.

**Neni 41**

Nisma ekonomike private është e lirë.
Ajo nuk mund të zhvillohet në kundërshtim me interesin shoqëror ose në mënyrën që mund ta dëmtojë sigurinë, lirinë dhe dinjitetin njerëzor. Ligji duhet të ofrojë programe dhe kontrolle të duhura në mënyrë që veprimtaria ekonomike publike e private të mund të drejtohet e të bashkërendohet për qëllime sociale.

**Neni 42**

Prona është publike ose private. Pasuritë ekonomike u përkasin shtetit, institucioneve ose personave privatë.Prona private njihet dhe garantohet me ligj, i cili përcakton mënyrat e fitimit të saj, të gëzimit dhe kufizimet e saj, me qëllim që të sigurohet funksioni i saj social dhe të bëhet e arritshme për të gjithë. Prona private mund të shpronësohet për shkaqe të interesit të përgjithshëm, me kompensim dhe në rastet e parashikuara me ligj .
Ligji përcakton normat dhe kufijtë e trashëgimisë ligjore dhe të asaj me testament dhe të drejtat e shtetit në çështjet e trashëgimisë.

**Neni 43**

Për interes të përgjithshëm, ndërmarrrjet specifike ose disa kategori ndërmarrjesh që kanë të bëjnë me shërbimet themelore publike, me burimet e energjisë ose me situata të monopolit që janë me interes parësor publik, që nga fillimi mund të shprehin rezerva ndaj shtetit, subjekteve publike ose bashkësive të punëtorëve ose të shfrytëzuesve ose mund t'u transferohen atyre nëpërmjet shpronësimit dhe kompensimit.

**Neni 44**

Me qëllim që të bëhet një shfrytëzim racional i tokës dhe të vendosen marrëdhënie të drejta sociale, ligji imponon detyrime mbi pronësinë private të tokës; cakton kufizime në numrin e pronave sipas rajonit dhe zones bujqësore; inkurajon dhe imponon përmirësimin e tokave, shndërrimin dhe riorganizimin e kooperativave; dhe ndihmon pronarët e vegjël dhe ata të mesëm.

Ligji parasheh dispozita në në dobit të zonave malore.

**Neni 45**

Republika njeh funksionin shoqëror të bashkëveprimit me karakter ndihme të ndërsjellë dhe pa synime spekulimi. Ligji përkrah dhe inkurajon bashkëpunimin me anë të mjeteve të përshtatshme dhe siguron karakterin dhe synimet e tij nëpërmjet kontrolleve përkatëse. Ligji parashikon masa për mbrojtjen dhe zhvillimin e artizanatit.

**Neni 46**

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes ekonomike dhe sociale të punëtorëve dhe në harmoni me kërkesat e prodhimit, Republika ua njeh të drejtën e punonjësve për të bashkëpunuar në administrimin e ndërmarrjeve, me mënyrat dhe brenda kufijve të caktuar me ligj.

**Neni 47**

Republika inkurajon dhe mbron kursimet në të gjitha format e tyre; rregullon, bashkërendon dhe mbikëqyr ushtrimin e autoritetit.

Nëpërmjet kursimeve të ndërsjella të qytetarëve ajo ndihmon qasjen në pronësi të banësës dhe të tokës së kultivuar drejtpërdrejtë, si dhe në investime të drejtpërdrejta ose të tërthorta në kombinatet e mëdha prodhuese të vendit.

***Kreu IV***
***Marrëdhëniet politike***

**Neni 48**

Të gjithë shtetasit, burra e gra, që kanë mbushur moshën madhore, kanë të drejtë vote. Vota është personale dhe e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Ushtrimi i saj është detyrë qytetare.

Për qytetarët që banojnë jashtë vendit, ligji cakton kushtet dhe modalitetet për të ushtruar të drejtat e tyre të votimit dhe u garanton se kjo e drejtë është e vlefshme Një zonë zgjedhore e italianëve që banojnë jashtë vendit duhet të caktohet në parlament; numri i ulëseve nga kjo zonë zgjedhore caktohet me dispozita, në përputhje me kriteret e caktuara me ligj.

E drejta e votës nuk mund të kufizohet, përveç në rast të paaftësisë civile ose si pasoje e një vendimi formës së prerë që ka të bëjë me dënim për vepër penale dhe në rastet e padenjësisë morale, të parapara me ligj.

**Neni 49**

Të gjithë shtetasit kanë të drejtë të organizohen lirisht në parti për të kontribuar me metoda demokratike në përcaktimin e politikës kombëtare.

**Neni 50**

Të gjithë shtetasit mund t'u drejtojnë petizione Dhomave për të kërkuar masa legjislative ose për të parashtruar kërkesa kolektive.

**Neni 51**

Të gjithë shtatasit e të dy gjinive mund të marrin pjesë në poste publike ose në funksione zgjedhore në kushte të barabarta, sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Për këtë qëllim, Republika duhet të miratojë masa të posaçme për të krijuar mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave.
Ligji mund t'u japë të drejta të barabarta qytetare italianëve që nuk banojnë në Itali, me qëllim që të kenë qasje në poste publike dhe në funksione zgjedhore.
Kushdo që zgjedhet ne një funksion publik ka të drejtë të ketë kohën e nevojshme për ta ushtruar atë funksion dhe ta ruajë vendin paraprak të punës.

**Neni 52**

Mbrojtja e Atdheut është detyrë e shenjtë e çdo qytetari.
Shërbimi ushtarak është I detyrueshëm në kufijtë dhe mënyrat e përcaktuara me ligj. Kryerja e shërbimit ushtarak nuk paragjykon punësimin e shtetasit, as ushtrimin e të drejtave politike. Organizimi i forcave të armatosura duhet të mbështetet në frymën demokratike të Republikës.

**Neni 53**

Të gjithë e kanë për detyrë të kontribuojnë në shpenzimet publike në përputhje me aftësitë e tyre për të paguar tatimin. Sistemi fiskal duhet të bazohet në kriteret e zhvillimit.

**Neni 54**

Të gjithë shtetasit kanë për detyrë të jenë besnikë ndaj Republikës dhe t'i respektojnë kushtetutën dhe ligjet.
Shtetasit të cilëve u janë besuar funksione publike, kanë për detyrë t'i kryejnë ato me disiplinë dhe me nder, duke dhënë betimin në rastet e përcaktuara me ligj.

## PJESA E DYTË
## ORGANIZIMI I REPUBLIKËS

### *Kreu I*
### *Parlamenti*

*Pjesa I*
*Dhomat*

**Neni 55**

Parlamenti përbëhet nga Dhoma e deputetëve dhe nga Senati i Republikës.
Parlamenti mblidhet në seancë të përbashkët të anëtarëve të të dy dhomave vetëm në rastet e parashikuara me Kushtetutë.

**Neni 56**

Dhoma e deputetëve zgjidhet me votim të përgjithshëm dhe të drejtpërdrejtë.
Numri i deputeteve është 630, dymbëdhjetë prej të cilëve zgjedhen nga zona e jashtme zgjedhore.
Të gjithë zgjedhësit të cilët ditën e zgjedhjeve kanë mbushur 25 vjet, mund të zgjedhen deputetë.
Ndarja e ulëseve midis zonave elektorale, me përjashtin të numrit të ulëseve të caktuara për zonat e tejoqeanike zgjedhore, kryhet duke pjesëtuar numrin e banorëve të Republikës, siç rezulton nga regjistrimi i fundit i përgjithshëm i popullsisë, me numrin

630 dhe duke i shpërndarë ulëset në përpjesëtim me popullsinë në çdo zonë elektorale, mbi bazën e herësve të plotë dhe të mbetjeve më të larta.

**Neni 57**

Senati i Republikës zgjedhet mbi baza rajonale, me përjashtim të ulëseve të caktuara për zonat zgjedhore tejoqeanike. Numri i senatorëve që duhet të zgjedhen është 315, gjashtë prej të cilëve zgjedhen në zonën zgjedhore tejoqeanike.
Asnjë rajon nuk mund të ketë më pak se shtatë senatorë; Molize duhet t'i ketë dy; Val d'Aosta një. Ndarja e ulëseve nëpër rajone, me përjashtim të numrit të ulëseve të caktuara për zonën zgjedhore tejoqeanike, në përputhje me dispozitat e nenit paraprak, bëhet në përpjesëtim me popullsinë e rajoneve, siç rezulton nga regjistrimi i fundit i përgjithshëm, mbi bazën e herësve të plotë dhe të mbetjeve më të larta.

**Neni 58**

Senatorët zgjedhen me votime të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta nga zgjedhësit që e kanë moshën 25 vjeçe. Zgjedhësit që kanë mbushur 40 vjet mund të zgjedhen senatorë.

**Neni 59**

Ish kryetarët e Republikës janë senatorë me të drejtë të përjetshme, përveç kur heqin dorë. Kryetari i Republikës. mund t'i emërojë senatorë të përjetshëm pesë shtetas që e kanë nderuar atdheun për merita të larta në fushën shoqërore, shkencore, artistike dhe në atë letrare.

**Neni 60**

Dhoma e Deputetëve dhe Senati i Republikës zgjidhen për pesë vjet. Mandati i secilës dhomë nuk mund të zgjatet, përveç me ligj dhe vetëm në rast lufte.

**Neni 61**

Zgjedhjet e për Dhomat e reja bëhen brenda 70 ditësh nga mbarimi i mandatit të Dhomave të mëparshme. Mbledhja e parë mbahet jo më vonë se 20 ditë pas zgjedhjeve. Kompetencat e dhomave të vjetra vazhdojnë deri në mbledhjen e dhomave të reja.

**Neni 62**

Dhomat duhet të mblidhen ditën e parë të punës në shkurt dhe në tetor. Secila dhomë mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme me nismë të kryetarit të saj ose të kryetarit të Republikës ose të 1/3 të anëtarëve të saj. Kur njëra dhomë mblidhet në sesion të jashtezakonshëm vetvetiu mblidhet edhe tjetra.

**Neni 63**

Secila dhomë duhet të zgjedhë kryetarin dhe sekretarin ndër anëtarët e saj.
Kur Parlamenti mblidhet në seancë të përbashkët, kryetari dhe sekretari janë të Dhomës së Deputetëve.

**Neni 64**

Secila dhomë miraton rregulloren e vet me shumicë absolute të anëtarëve të vet.
Seancat janë publike; megjithatë secila nga të dy dhomat dhe Parlamenti në mbledhjen e tyre të përbashkët mund të vendosin të mblidhen në seancë të mbyllur.
Vendimet e secilës dhomë dhe të parlamentit nuk janë të vlefshme nëse nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve të saj dhe nëse nuk miratohen nga shumica e të pranishmëve, përveç kur kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar.

Anëtarët e qeverisë, edhe kur nuk janë anëtarë të dhomave, kanë të drejtë dhe nëse kërkohet, janë të detyruar të marrin pjesë në seanca. Ata duhet të dëgjohen sa herë që e kërkojnë këtë.

**Neni 65**

Ligji përcakton rastet e pazgjedhshmërise dhe të papajtueshmërisë me funksionin e deputetit ose të senatorit.
Askush nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i të dy dhomave.

**Neni 66**

Secila dhomë vërteton mandatin e anëtarëve të vet dhe shkaqet e moszgjedhjes dhe mospajtimit që mund të ndodhin në një fazë të mëvonshme.

**Neni 67**

Çdo anëtar i Parlamentit përfaqëson kombin dhe i kryen detyrat e veta pa mandat detyrues.

**Neni 68**

Anëtarët e Parlamentit nuk mund të ndiqen për mendimet e shprehura dhe për votën e dhënë gjatë ushtrimit të funksioneve të veta. Pa lejen e Dhomës ku bën pjesë, asnjë anëtar i Parlmentit nuk mund t'i nënshtrohet bastisjes personale as t'i bastiset shtëpia as nuk mund të arrestohet a të privohet nga liria, as të burgoset, përveç kur vendimi i gjykatës për dënim me burg është i plotëfuqishëm, ose kur anëtari është zënë duke kryer një vepër penale për të cilin është i detyrueshëm arrestimi në flagrancë E njëjta leje kërkohet për t'i përgjuar bisedat ose komunikimet e anëtarëve të Parlementit, të çfarëdo forme qofshin dhe për t'i sekuestruar korrepondencat e tyre.

**Neni 69**

Anëtarët e Parlamentit marrin një shpërblim të caktuar me ligj.

*Pjesa II*
*Formimi i ligjeve*

**Neni 70**

Funksioni ligjvënës ushtrohet kolektivisht nga të dy dhomat.

**Neni 71**

Qeveria, çdo anëtar i Parlamentit dhe ato subjekte dhe organe që janë të autorizuar me ligjin kushtetues inicojnë legjislacionin. Njerëzit mund ta inicojnë legjislacionin, duke propozuar një projektligj të hartuar me nene dhe i nënshkruar së paku nga 50.000 zgjedhës.

**Neni 72**

Çdo projektligj, i paraqitur në njërën dhomë, në përputhje me rregulloren e saj të punës, shqyrtohet nga një komision dhe pastaj nga vetë dhoma, që e miraton atë nen për nen me një votim përfundimtar. Rregullorja e punës cakton procedura të përshpejtuara për projektligjet që cilësohen urgjente. Ato po ashtu mund të caktojnë në cilat raste dhe forma mund t'u ngarkohetshqyrtimi dhe miratimi i projektligjeve komisioneve, duke përfshirë edhe komisionet e përhershme, të përbëra ashtu që të pasqyrojnë përpjesëtimin e grupeve parlamentare. Madje në raste të tilla, deri në çastin e miratimit të tij përfundimtar, projektligji mund t'i kthehet Dhomës, nëse Qeveria ose një e dhjeta e anëtarëve të Dhomës ose një e pesta e komisionit kërkojnë të debatohet dhe të votohet

nga vetë dhoma ose t'i paraqitet dhomës për miratim përfundimtar vetëm me votim.Rregullorja e punës i cakton mënyrat me të cilat bëhen publike procedurat e komisioneve.
Procedura e rregullt e shqyrtimit dhe e miratimit të drejtpërdrejtë nga ana e Dhomës vendoset gjithmonë për projektligjet, për çështjet kushtetuese dhe zgjedhore që ndihmojnë legjislacionin, ratifikimin e traktateve ndërkombetare dhe, miratimin e buxheteve dhe llogarive buxhetore.

**Neni 73**

Ligjet shpallen nga Presidenti i Republikës brenda një muaji nga data e miratimit. Nëse dhomat, secila me shumicë absolute të anëtarëve të vet, konsiderojnë se një ligj është urgjent, atëherë ligji shpallet brenda afatit të caktuar në të.
Ligjet publikohen menjëherë pas publikimit dhe hyjnë në fuqi 15 ditë pas publikimit, përveç nëse vetë ligjet nuk caktojnë ndonjë afat tjetër.

**Neni 74**

Kryetari i Republikës, para se ta publikojë një ligj, mund të kërkojë nga dhomat, me një porosi të arsyetuar, ta rishqyrojnë ligjin.
Nëse dhomat e miratojne sërish ligjin, atëherë ky ligj duhet të publikohet.

**Neni 75**

Referendumi popullor do të mbahet për ta shfuqizuar, plotësisht ose pjesërisht një ligj ose një masë ligjore, kur këtë e kërkojnë 500.000 zgjedhës ose pesë këshilla rajonalë.
Referendumet nuk janë të pranueshme kur është fjala për ligjet e taksave, ligjet buxhetore, ligjet për amnisti dhe për falje ose për ligjet që lejojnë ratifikimin e traktateve ndërkombëtare.
Të gjithë qytetarët me të drejtë vote për Dhomën e Deputetëve kanë të drejtë pjesëmarrjeje në referendume Propozimi që i nënshtrohet një referendumi miratohet nëse shumica ka marrë pjesë në votim dhe nëse shumica e fletëvotimeve kanë qenë të vlefshme. Ligji përcaktonmodalitetet e mbajtjes së referendumit.

**Neni 76**

Ushtrimi i funksionit ligjvënës nuk mund t'idelegohet Qeverise, përderisa të mos jenë caktuar parimet dhe kriteret, pastaj vetëm për një kohë të kufizuar, dhe për qëllime të përcaktuara qartë.

**Neni 77**

Pa një akt të dhomave, Qeveria nuk mund të nxjerrë dekrete me fuqi ligjore të zakonshme. në raste të Kur qeveria, miraton masa të përkohshme me fuqi ligjore të jashtëzakonshme të domosdoshmërisë dhe tëurgjencës, po atë ditë ajo duhet t'ia paraqesë ato dhomës për konfirmim, të cilat, edhe pse të shfuqizuar, duhet të thirren enkas për këtë qëllim dhe të mblidhen brenda pesë ditësh.
Dekretet e humbasin fuqinë që në fillim, nëse nuk konfirmohen brenda 60 ditësh nga publikimi i tyre.
Megjithatë dhomat mund t'i rregullojnë me ligj raportet juridike që dalin nga dekretet e pakonfirmuara.

**Neni 78**

Dhomat shqyrtojnë gjendjen e luftës dhe i japin kompetenca të nevojshme Qeverisë.

**Neni 79**

Amnistia dhe falja jepen me një ligj të miratuar nen për nen nga dy të tretat e shumicës së të dy dhomave në votimin përfundimtar. Ligji që jep amnisti dhe falje cakton afatin për zbatimin e tyre Amnistia dhe falja kurrsesi nuk mund të zbatohen për veprat e kryera pas paraqitjes së projektligjit në Parlament.

**Neni 80**

Dhomat lejojnë me ligj ratifikimin e trakteve ndërkombëtare që janë të një karakteri politik, ose që kërkojnë arbitrazh e zgjidhje ligjore, ose që sjellin ndryshime territoriale ose barra financiare ose ndryshime të legjislacionit.

**Neni 81**

Dhomat miratojnë për çdo vit buxhetin dhe llogaritë buxhetore që i paraqet Qeveria.
Buxheti i përkohshëm i nuk mund të ndahet, përveç nëse vendoset me ligj dhe për periudha kohore që në tërësi nuk kalojnë periudhën kohore prej katër muajsh.
Nuk është e mundshme të caktohen taksa në reja dhe shpenzime me ligjin që aprovon buxhetin.
Çdo ligj tjetër që cakton shpenzime të reja ose më të mëdha, duhet t'i specifikojë burimet për t'i përballuar këto shpenzime.

**Neni 82**

Çdo dhomë mund të zhvillojë hetime për çështjet me interes të përgjithshëm.
Për këtë qëllim, ajo formon një komision të përbërë në atë mënyrë që të pasqyrojë përfaqësimin përpjesëtimor të grupeve parlamentare Komisioni hetimor i kryen hetimet dhe shqyrtimet me kompetenca dhe kufizime të njëjta si një autoritet giyqësor.

***Kreu II***
***Kryetari i Republikës***

**Neni 83**

Kryetarin e Republikës e zgjedh Parlamenti në një seancë të përbashkët të anëtarëve të tij.
Në zgjedhje marrin pjesë tre delegatë nga çdo rajon, të zgjedhur nga Këshilli Rajonal për të siguruar se minoritet janë të përfaqësuara. Val d'Aosta ka vetëm një delegat.
Zgjedhja e Kryetarit të Republikës bëhet me votim të fshehtë nga dy të tretat e shumicës së Parlamentit.
Pas votimit të tretë do të mjaftojë shumica absolute.

**Neni 84**

Çdo qytetar që ka mbushur 50 vjet dhe që gëzon të drejta civile dhe politike mund të zgjedhet kryetar i Republikës Funksioni i kryetarit të Republikës nuk përputhet me asnjë funksion tjetër.
Shpërblimi dhe të ardhurat e tjera të kryetarit caktohen me ligj.

**Neni 85**

Kryetari i Republikës zgjedhet për shtatë vjet. Tridhjetë ditë para mbarimit të mandatit, kryetari i Dhomës së Deputetëve dhe delegatët rajonalë do ta thërrasin një seancë të përbashkët të Parlamentit, për ta zgjedhur kryetarin e ri të Republikës.
Nëse dhomat janë të shpërndara ose nëse kanë kaluar më pak se tre muaj nga shpërndarja e tyre, zgjedhja do të bëhet brenda pesëmbëdhjetë ditësh pas mbledhjes së dhomave të reja.

Në ndërkohë vazhdon mandati i kryetarit aktual.

**Neni 86**

Në të gjitha rastet kur kryetari i Republikës nuk mund t'i ushtrojë funksionet, ato do të ushtrohen nga kryetari i Senatit.
Në rastin e një paaftësie të përshershme ose të vdekjes ose të dorëheqjes së kryetarit të Republikës, kryetari i Dhomës së Deputetëve cakton zgjedhjen e një kryetari të ri të Republikës brenda pesembedhjetë ditësh, përveç në rastin e një mandati më të gjatë të parashikuar, nëse dhomat shpërdahen ose kur nevojiten më pak se tre muaj për t'u bërë shpërndarja e tyre.

**Neni 87**

Kryetari i Republikës është shef i shtetit dhe përfaqëson unitetin kombëtar.
Ai mund t'u dërgojë porosi dhomave.
Kryetari do të: lejojë që projektligjet e e inicuara nga qeveria të futen në dhoma; shpallë ligje dhe do të nxjerrë dekrete që kanë fuqi ligjore si dhe rregullore;
shpallë referendumin popullor në rastet e parashikuara me kushtetutë;
emërojë funksionarët e shtetit, në rastet e caktuara me ligj;
akreditojë dhe do të pranojë përfaqësuesit diplomatikë dhe, kur kërkohet, do t'i ratifikojë traktatet ndërkombëtare që janë lejuar nga Dhoma, Kryetari i Republikës është komandant i forcave të armatosura, kryeson Këshillin e Lartë të Mbrojtjes që është formuar sipas ligjit, shpall gjendjen e luftës që është vendosur nga dhomat.
Kryetari do ta kryesojë Këshillin e Lartë të Drejtësisë.
Kryetari mund të falë dhe të ndryshojë dënimet.
Kryetari jep titujt e nderit të Republikës.

**Neni 88**

Kryetari i Republikës, pasi t'i ketë dëgjuar kryetarët e dhomave, mund ta shpërndajë Parlamentin, ose vetëm njërën dhomë.
Kryetari i republikës nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë në gjashtë muajt e fundit të mandatit të tij, përveç nëse periudha e cekur përkon plotësisht ose pjesërisht me gjashtë muajt e fundit të mandatit të Parlamentit.

**Neni 89**

Asnjë akt i kryetarit të republikës nuk është i vlefshëm nëse nuk nënshkruhet nga ministrat që e kanë propozuar, të cilët e marrin përsipër përgjegjësinë.Aktet që kanë vlerë ligjore dhe aktet e tjera të caktuara me ligj duhet të nënshkruhenedhe nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

**Neni 90**

Kryetari i Republikës nuk përgjigjet për veprimet e kryera gjatë ushtrimit të funksionit të tij, përveç në rast tradhtie të madhe ose në rast se shkel kushtetutën.
Në raste të tilla kryetari mund të akuzohet nga parlamenti në seancë të përbashkët, me shumicë absolute të anëtarëve të tij.

**Neni 91**

Kryetari i Republikës, para se ta marrë postin e tij, jep betimin për besnikëri ndaj Republikës dhe për respektimin e Kushtetutës para Parlamentit, në seancë të përbashkët.

## *Kreu III*
## *Qeveria*
### *Pjesa I*
### *Këshilli i Ministrave*

**Neni 92**

Qeveria e Republikës përbëhet nga kryetari i Këshillit dhe nga ministrat, të cilët formojnë së bashku Këshillin e Ministrave.
Kryetari i Republikës emëron kryetarin e Këshillit të Ministrave dhe, me propozimin e tij/saj, emëron edhe ministrat.

**Neni 93**

Para se t'i marrin postet, Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe ministrat, betohen para kryetarit të Republikës.

**Neni 94**

Qeveria duhet ta ketë besimin e të dy dhomave. Secila dhomë falë ose tërheq besimin me anë të një mocioni të aresyetuar dhe të votuar me thirrje emërore.
Brenda dhjetë ditësh, që nga formimi i saj, qeveria do të dalë para dhomave për ta marrë votëbesimin.
Votimi kundër një proponimi të qeverisë nga njëra dhomë ose nga të dyjat, nuk lë si pasojë detyrimin për të dhënë dorëheqjen.
Mocioni i mosbesimit duhet të nënshkruhet se paku nga një e dhjeta e anëtarëve të Dhomës dhe nuk mund të diskutohet për të më më heret se tri ditë nga paraqitja e tij.

**Neni 95**

Kryetari i Këshillit të Ministrave udhëheq politikën e përgjithshme të Qeverisë dhe përgjigjet për të. Ai siguron lidhjen e synimeve politike dhe administrative, duke ndihmuar dhe bashkërenduar veprimtarinë e ministrave.
Ministrat përgjigjen kolektivisht për aktet e Këshillit të Ministrave; ata janë individualisht përgjegjës për aktet e dikastevere të tyre. Ligji parashikon organizimin e Kryeministrisë si dhe cakton numrin, kompetencat dhe organizimin e ministrive.

**Neni 96**

Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe ministrat, edhe nëse heqin dorë nga funksioni i tyre, i nënshtrohen gjykatës së rëndomtë për vepra penale të kryera gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Autorizimi jepet nga Senati i Republikës ose nga Dhoma e Deputetëve, në përputhje me dispozitat e caktuara me ligjin kushtetues.

### *Pjesa II*
### *Administrata publike*

**Neni 97**

Zyrat publike organizohen sipas dispozitave ligjore, në mënyrë që të sigurohen mbarëvajtja dhe paanësia e administratës.
Rregulloret e zyrave në organizimin e zyrave përcaktojnë sferat e kompetencës, detyrat dhe pergjegjësitë e funksionarëve.
Nëpunësit në administratë publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

**Neni 98**

Shërbyesit civilë janë ekskluzivisht në shërbim të kombit.
Nëse ata janë anëtarë të Parlamentit, ata nuk mund të gradohen në shërbimet e tyre,përveç në bazë të vjetërsisë në punë. Gjykatësve, ushtarakëve profesionistë Në shërbim aktiv, zyrtarëve që zbatojnë ligjin dhe përfaqësuesve diplomatikë dhe konzullarë jashtë vendit, igji mund t'ua kufizojë të drejtën për t'u bërë anëtarë të partive politike.

*Pjesa III*
*Organet ndihmëse*

**Neni 99**

Këshilli kombëtar për ekonomi dhe punë, ashtu siç është caktuar me ligj, përbëhet nga ekspertë dhe përfaqësues të kategorive ekonomike, përpjesëtimisht me rëndësinë e tyre numerike dhe cilësore.
Ai është organ këshillëdhënësi dhomave dhe i Qeverisë për ato çështje dhe funksione që i caktohen me ligj.
Ai mund të inicojë legjislacionin dhe të kontribuojë në hartimin e legjislacionit ekonomik e
shoqëror, sipas parimeve dhe në kuadër të kufizimeve të caktuara me ligj.

**Neni 100**

Këshilli i shtetit është organ konsultativ juridiko-administrativ që mbikëqyr zbatimin e drejtësisë.
Gjykata e kontrollit ushtron kontrollin parandalues të ligjshmerise së masave të qeverisë, si dhe mbikëkëqyrjen e mëtejme të administrimit të buxhetit të shtetit.
Ajo merr pjesë, në rastet dhe në format e caktuara me ligj, në kontrollin e administrimit financiar të institucioneve që marrin ndihma të rregullta buxhetore nga shteti.
Ajo raporton drejtpërsëdrejti para dhomave lidhur me rezultatet e kontrolleve të kryera.
Të dyja dhomave dhe anëtarëve të tyre, ligji u garanton pavarësi nga qeveria.

***Kreu IV***
***DREJTËSIA***
*Pjesa I*
*Organizimi i sistemit të drejtësisë*

**Neni 101**

Drejtësia ushtrohet në emër të popullit. Gjyqtarët i nënshtrohen vetëm ligjit.

**Neni 102**

Funksioni gjyqësor ushtrohet nga gjyqtarë të caktuar e të rregulluar me rregulloret që kanë të bëjnë me drejtësinë.
Nuk mund të ketë gjyqtarë të jashtëzakonshëm ose gjyqtarë të posaçëm.
Vetëm brenda organeve të zakonshme gjyqësore mund të formohen grupe të specializuara për çështje specifike. Në këto grupe mund të marrin pjesë njerëz të kualifikuar që nuk janë anëtarë të gjykatës. Ligji rregullon rastet dhe format e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të popullit në ushtrimin e drejtësisë.

**Neni 103**

Këshilli i shtetit dhe organet e tjera të administratës gjyqësore kanë jurisdiksion për mbrojtjen e të drejtave ligjore para administratës publike dhe, sidomos të çështjeve të caktuara me ligj, por edhe të të drejtave subjektive.
Gjykata e kontrollit ka jurisdiksion në çështjet e kontabilitetit publik dhe ne fushat e tjera të përcaktuara me ligj.
Gjykatat ushtarake në kohë lufte kanë jurisdiksionin e caktuar me ligj. Në kohë paqeje ato kanë jurisdiksion vetëm për veprat penale të kryera nga pjesëtarë të forcave të armatosura.

**Neni 104**

Drejtësia është sektor autonom dhe i pavarur nga çdo autoritet tjetër. Këshilli i Lartë i Drejtësisë kryesohet nga Kryetari i Republikës.
Kryetari i parë dhe prokurori i përgjitshëm i Gjykatës së kasacionit janë anëtarë me të drejta të barabarta.
Dy të tretat e anëtarëve zgjedhen nga të gjithë gjyqtarët e rregullt të kategorive te ndryshme, kurse një të tretën e zgjedh Parlamenti në mbledhje të përbashkët, në mesin e profesorët e universitetit të drejtësisë dhe nga avokatët me përvojë pune mbi pesëmbëdhjetë vjet.
Keshilli zgjedh një nënkryetar në mesin e anëtarëve të caktuar nga parlamenti.
Anëtarët e zgjedhur të këshillit qëndrojnë në detyrë katër vjet dhe nukmund të rizgjedhen menjëherë. Deri sa ushtrojnë këtë funksion, ata nuk mund ttë regjistrohen në regjistrin profesional dhe as të jenë anëtarë të Parlamentit ose të këshillit rajonal.

**Neni 105**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në përputhje me rregulloret e sistemit të drejtësisë, ka kompetencë për punësim, për emërime, për promovime dhe për masa disiplinore ndaj gjykatësve.

**Neni 106**

Emërimet e gjykatësve bëhen me konkurs. Ligji për rregulloret e sistemit të drejtësisë, lejon emërimin, e gjykatësve të nderit, madje edhe me votë, për të gjitha funksionet që ushtrojnë gjykatësve individualë.
Me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, profesorët e rregullt universitarë të fushës së drejtësisë dhe avokatët me përvojë pesëmbëdhjetë vjeçare dhe të regjistruar në listat e posaçme professionale për gjykata më të larta, mund të emërohen si këshilltarë të kasacionit për meritat e tyre të jashtëzakonshme.

**Neni 107**

Gjykatësit nuk mund të largohen nga funksioni. Ata nuk mund të pushohen ose te suspendohen nga puna as të caktohen në gjykata ose në funksione të tjera, përveç nëse një vendim të tillë e merr Këshilli i Lartë i Drejtësisë, qoftë për arsyet dhe garancitë e caktuara në bazë të dispozitave që kanë të bëjnë me organizimin e sistemit të drejtësisë ose me pëlqimin vet gjykatësve. Ministri i Drejtësisë ka kompetencë të marrë masa disiplinore.
Gjykatësit dallohen midis tyre vetëm në bazë të funksioneve të tyre të ndryshme.
Prokurori shtetëror gëzon garanci të caktuara në të mirë të prokurorit, në bazë të dispozitave lidhur me organizimin e sistemit të drejtësisë.

**Neni 108**

Dispozitat lidhur me organizimin e sistemit të drejtësisë dhe megjykatësit caktohen me ligj. Ligji siguron pavarësinë e gjykatësve të gjykatave të posaçme, të prokurorve

shtetërorë të atyre gjykatave dhe të personave të tjerë që marrin pjesë në administrimin e drejtësisë.

**Neni 109**

Autoritetet gjyqësore e shfrytëzojnë drejtpërsëdrejti policinë gjyqësore.

**Neni 110**

Pa paragjykuar kompetencat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministri i Drejtësisë është përgjegjës për organizimin dhe funksionimin e atyre shërbimeve që kanë të bëjnë me drejtësinë.

*Pjesa II*
*Rregulloret e juridiksionit*

**Neni 111**

Juridiksioni zbatohet nëpërmjet procesit të duhur të rregulluar me ligj.
Të gjitha gjykimet në gjykata mbahen me procedura gjyqësore të palëve kundërshtare, prandaj palët kanë të drejtë në kushte të barabarta, para një gjykatësi të paanshëm në pozitën e palës së tretë.
Ligji parashikon kohëzgjatje të arsyeshme të gjykimeve. Në gjykimet e lëndëve penale, ligji parashikon që i akuzuari i supozuar do të informohet brenda një kohe sa më të shkurtër, në mënyrë të besueshme për natyrën dhe arsyet e akuzës, që i janë ngarkuar atij dhe do t'i jepen në dispozicion kohë dhe kushte adeguate për të përgatitur mbrojtjen e tij.
I pandehuri do të ketë të drejtë të merret në pyetje ose t'i ketë marrë në pyetje para një gjykatësi, personat që e akuzojnë atë dhe t'i thërrasë dhe t'i marrë në pyetje personat për mbrojtje, në kushte të njëjta sikurse si gjatë ndjekjes penale, si dhe të drejtën për të ofruar të gjitha dëshmitë e tjera në të mirë të mbrojtjes.
I pandehuri ka të drejtë të ndihmohet nga një përkthyes, në rastin kur ai ose ajo nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën në të cilën mbahet procesi gjyqësor.
Në procesin penal formimi i dëshmisë bazohet në parimin e theshethemeve kundërshtuese. Faji i të pandehurit nuk mund të konstatohet në bazë të deklaratave të personave, të cilët pa zgjedhjen e vet të lirë, gjithnjë, i shmangen vullnetarisht marrjes në pyetje nga i pandehuri ose nga avokati i tij. Ligji rregullon rastet në të cilat, formimi i dëshmisë nuk bëhet në një proces kundërshtues me pajtimin e të pandehurit ose për arsye të pamundësisë së konstatimit objektiv ose për shkak të kryerjes së paligjshme të vërtetuar.
Në të gjitha vendimet gjyqësore do të përfshihet një deklaratë e arsyeve. Ankesat në Gjykatën e Kasacionit, në rastet e shkeljeve të ligjit, gjithnjë lejohen të bëhen kundër dënimeve dhe kundër masave që prekin lirinë personale, të shqiptuara nga gjykatat e rregullta dhe ato speciale.Nga ky rregull mund të hiqetdorë vetëm në rastet e dënimeve që japin gjykatat e luftës në kohë lufte. Ankesat që bëhen në Gjykatën e Kasacionit kundër vendimeve të Këshillit të shtetit dhe të Gjykatës së diktimit lejohen vetëm për shkaqe të juridiksionit.

**Neni 112**

Prokurori publik është i obliguar të inicojë procedura penale.

**Neni 113**

Mbrojtja gjyqësore e të drejtave dhe interesave të ligjshme para organeve të drejtësisë, së rregullt ose administrative gjithnjë lejohet kundër akteve të adminstratës publike.

Mbrojtja e tillë gjyqësore mund të mospërjashtohet ose të kufizohet për lloje të veçanta të ankesave ose për kategori të veçanta të akteve. Ligji përcakton cilat organe gjyqësore mund t'i shfuqizojnë aktet e administratës publike ne rastet dhe me pasojat e parashikuara nga vetë ligji.

## *Kreu V*
## *Rajonet, krahinat dhe komunat*

### Neni 114

Republika përbëhet nga njësitë administrative si: komunat, krahinat, qytetet metropolite, rajonet dhe shteti. Komunat, krahinat, qytetet metropolite dhe krahinat janë entitete autonome me statute, kompetenca dhe me funksione të veta, në përputhje me parimet e përcaktuara në kushtetutë.
Roma është kryeqyteti i Republikës. Statusi i saj rregullohet me ligjin e shtetit.

### Neni 115

*(i anuluar)*

### Neni 116

Friuli-Venecia Gulia, Sardinia, Sicilia, Trentino-Alto Adixhee dhe Vald'Aosta/ kanë forma dhe kushte të veçanta të autonomisë, në përputhje mestatutet e posaçme të miratuara me ligjin kushtetues.
Rajonin Trentino-Alto Adixhe e përbëjnë krahinat autonome të Trentos dhe të Bolxanos. Format dhe kushte e posaçme shtesë të autonomisë, që kanë të bëjnë me fushat e specifikuara në nenin117, paragrafët tre dhe dy, shkronja *l),* që kanë të bëjnë me nevojat organizative të Gjykatës së pajtimit - dhe shkronjat n) dhe s) mund t'i atribuohen rajoneve të tjera me ligjin e shtetit, me nismën e rajonit përkatës, pas këshillimit me autoritetet vendore, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 119. Ligji i sipërpërmendur miratohet nga të dyja dhomat e Parlamentit, me shumicë absolute të anëtarëve të tyre, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet shtetit dhe rajonit të interesuar.

### Neni 117

Pushtetin ligjvënës e ushtrojnë shteti dhe rajonet, në përputhje me kushtetutën dhe me detyrimet e tjera që dalin nga normat juridike të BE-së dhe nga detyrimet ndërkombëtare. Shteti ka kompetenca të veçanta të ligjvënies në çështjet si në vijim:
a) politika e jashtme dhemarrëdhëniet ndërkombëtaretë shtetit; marrëdhëniet ndërmjetshtetit dhe Bashkimit Evropian; e drejta e azilit dhe statusi juridik i shtetasve jashtë BE-së;
b) imigrimi;
c) marrëdhëniet ndërmjet e Republikës dhe besimeve fetare;
d) mbrojtja dhe forcat e armatosura; sigurimi shtetëror; armatimi, munizioni dhe aksplozivi;
e) monedha, mbrojtja e kursimeve dhe tregjet financiare; mbrojtja e konkurrencës së lirë; sistemi i huaj valutor; sistemet e caktimit të taksave shtetërore dhe të kontabilitetit; barazimi i mjeteve finanziare
f) organet shtetërore dhe ligjet përkatëse të zgjedhjeve; referendumet në nivel kombëtar; zgjedhjet në Parlamentin Evropian;
g) organizimi juridik dhe administrativ i shtetit dhe i zyrave publike kombëtare;
h) rendi dhe siguria publike, me përjashtim të policisë administrative vendore;
i) shtetësia, zyrat e gjendjes civile dhe të regjistrimit civil
l) juridiksioni dhe e drejta procedurale; e drejta civile dhe ligji penal; sistemi juridik administrativ;

m) përcaktimi i nivelit themelor të përfitimeve që kanë të bëjnë me të drejtat civile dhe sociale të garantuara në mbarë territorin kombëtar;
n) dispozitat e përgjithshme për arsimin;
o) sigurimi social dhe pensionet;
p) legji elektoral, organet udhëheqëse dhe funksionet themelore tëkomunave, të krahinave dh të qyteteve metropolite;
q) doganat, mbrojtja e kufijvet kombëtar dhe mbrojtja ndërkombëtare;
r) peshat dhe masat; koha standarde; bashkërendimi statistikor dhe i kompjuterizuari të dhënave të administratës shtetërore, rajonale dhe lokale; punët intelektuale;
s) mbrojtja e mjedisit, e ekosistemit dhe e trashëgimisë kulturore;
Legjislacioni konkurent zbatohet në këto çështje:
marrëdhëniet ndërkombëtaredhe të rajoneve të BE-së;
tregu i jashtëm; mbrojtja dhe sigurianë punë;
arsimi, lidhur me autonominë e institucioneve arsimore dhe me përjashtim të arsimit profesional dhe të trajnimit; profesionet;
kërkimet shkencore dhe teknologjike dhe mbështetja e risive në sektorët prodhues; mbrojtja e shëndetit; ushqimi;
sportet; planifikimi i shfrytëzimit të tokës;
portet dhe aeroportet civile;
rrjetet e mëdha të transportit dhe të navigacionit;
komunikimet; prodhimi kombëtar, transporti dhe shpërndarja e energjisë;
sigurimi social plotësues;
harmonizimi i llogarive publike dhe bashkërendimi i financave publike dhe sistemi i caktimit të taksave; shtimi i pasurive kulturore dhe mjedisore, duke përfshirë promovimin dhe organizimin e aktiviteteve kulturore;
bankat e kursimit, bankat bujqësore, institucionet rajonale për kredi; institucionet kreditore për toka dhe për bujqësi.
Në çështjet e përfshira në Legjislacionin konkurent, rajonet kanë pushtet legjislativ,me pëjashtim të përcaktimit të parimeve themelore, që janë të mbarështruar në legjislacionin shtetëror.
Rajonet kanë kompetenca Legjislative në të gjitha çështjet që nuk janë përfshirë qartë në legjislacioni shtetëror Rajonet dhe krahinat autonome të Trentos dhe Bolxanos, marrin pjesë në procesin përgatitor të marrjes së vendimeve lidhur me aktet legjislative të BE-së në fushat që janë nën përgjegjësinë e tyre.
Ato po ashtu janë përgjegjëse për zbatimin e marrëveshjeve nërkombëtare dhe të masave të BE-së lidhur me rregullat e përcaktuara në ligjin shtetëror, që rregullojnë ushtrimit e kompetencave plotësuese nga ana e shtetit, në rast të mospërmbushjes së detyrimeve nga ana e rajoneve dhe krahinave autonome.
Kompetencat mbikëqyrëse do t'i jepen shtetit përkitazi me çështjet e legjislacionit eksklusiv, lidhur me delegimet e këtyre kompetencave në rajone.
Kompetencat mbikëqyrëse do t'u jepen rajoneve në të gjitha çështjet thmelor.
Komunat, krahinat dhe qytetet metropolite kanë kompetenca mbikëqyrëse për organizimin dhe ushtrimin e funksioneve që u janë dhënë atyre.
Ligjet rajonale do të heqin çdo pengesë që nuk lejon barazinë e plotë midis burrave dhe grave në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike dhe do të promovojnë qasje të barabartë në funksionet e zgjedhura për burra dhe gra. Marrëveshjet ndërmjet një rajoni dhe rajoneve të tjera që synojnë përmirësimin e funksionimit në rajon dhe që, po ashtu, mund të parashikojnë formimin e organeve të përbashkëta, do të ratifikohen me ligjin rajonal.
Në fushat që janë përgjegjësi e tyre, rajonet mund të arrijnë marrëveshje me shtetet e huaja dhe me autoritetet vendore të shteteve të tjera, në rastet caktuar dhe në përputhje me format e caktuara me legjislaconin shtetëtror.

**Neni 118**

Funksionet administrative u jepen komunave, përveç nëse ato nuk u jepen krahinave, qyteteve metropolite dhe rajoneve ose shtetit, në përputhje me parimet e vartësisë, të diferencimit dhe të përpjestimit,për të siguruar zbatimin e tyre të njëtrajtshëm.
Komunat, krahinat, dhe qytetet metroploite ushtrojnë funksionet e veta ddministrative si dhe funksionet që ua cakton shteti ose legjislacioni rajonal, Në përputhje me kompetencat e tyre përkatëse.
Legjislacioni shtetëror do të parashikojë një veprim të bashkërenditur ndërmjet shtetit dhe rajneve, në çështjet, sipas nenit 117 paragrafi dy, shkronjat b) dhe h) e, po ashtu, do të parashikojë marrëveshje dhe veprim të bashkërenditur në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore.
Shteti, rajonet, qytetet metropolite, krahinat dhe komunat, do të mbështesin nismat autonome të qytetarëve, si individë dhe si anëtarë të shoqatave, lidhur me veprimtaritë me interes të përgjithshëm, mbi bazën e parimit të vartshmërisë.

**Neni 119**

Komunat, krahinat, qytetet metropolite dhe rajonet, do të kenë autonomi të të hyrave materiale dhe të shpenzimeve.
Komunat, krahinat, qytetet metroploite dhe rajonet do të kenë burime të pavaruara financiare.
Ato caktojnë dhe mbledhin tatimet dhe do t'i vjelin të hyrat e veta, në përputhje me kushtetutën dhe me parimet e bashkërendimit të financave shtetërore dhe me sistemin fiskal.
Ato marrin pjesë në të ardhurat nga tatimet që kanë të bëjnë me territorin përkatës.
Legjislacioni shtetëror krijon një fond ndihmashpër ato territore që kanë shkallë më të ulët të vjeljes së taksave për kokë banori.
Të ardhurat që dalin nga burimet e lartpërmendura, do t'ua mundësojnë komunave, krahinave, qyteteve metroploite dhe rajoneve, t'i financojnë funksionet publike që u janë caktuar.
Shteti do të ndajë mjete financiare shtesëdhe do të marrë masa të posaçme, në dobi të komunave, krahinave, qyteteve, metroploite dhe të rajoneve më specifike, për të ndihmuar zhvillimin ekonomik, unitetin social dhe solidaritetin, për të zvogëluar pabarazinë ekonomike dhe sociale, për të intensifikuar ushtrimin e të drejtave të individit ose për të arritur qëllime, që janë të ndryshme nga ato që janë realizuar gjatë ushtrimit të përditshëm të funksioneve të tyre.
Komunat, krahinat , qytetet metropolite dhe rajonet kanë pasuritë e veta, të cilat u janë ndarë në bazë të parimeve të përgjithshme, të caktuara me legjislacionin shtetëror.
Ato mund të futen në borxh vetëm për të financuar shpenzimet për investime.
Përjashtohet çdo garanci e shtetit në huatë e kontraktuara.

**Neni 120**

Rajonet nuk mund të vendosin taksa për import ose eksport as për transit midis rajoneve as të marrin masa që, në çfarëdo mënyre, pengojnë lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave ndërmjet rajoneve. Rajonet nuk mund të kufizojnë të drejtën e qytetarëve për të punuar në çfarëdo pjese të territorit kombëtar, Qeveria mund të ndërhyjë dhe të zëvendësojë organet e rajoneve, qyteteve metropolite, krahinavedhe komunave, vetëm nëse këto nuk i kanë respektuar ligjet dhe marrëveshjet ose legjislacionin e BE-sëose në rast rreziku të madh për sigurinë publike, si dhe kur një veprim i tillë është i nevojshëm për ta mbrojtur unitetin juridik ose ekonomik, dhe, sidomos, për të garantuar nivelin themelor të interesave që kanë të bëjnë me të drejtat civile e shoqërore, pa marrë parasysh kufijtë gjeografikë të pushteteve vendore. Ligji do të përcaktojë procedurat që

garantojnë se kompetencat e vartësve ushtrohen, duke respektuar parimin e vartshmërisë dhe të bashkëpunimit të sinqertë.

**Neni 121**

Organet rajonale janë:
Këshilli rajonal, Komiteti drejtues rajonal dhe Kryetari i rajonit. Këshilli rajonal ushtron kompetencat ligjvënëse që i janë dhënë rajonit si dhe funksionet që i janë besuar me kushtetutë dhe me ligje. Këshilli mund t'i paraqet projektligje parlamentit Komiteti drejtues rajonal është organ ekzekutiv i rajonit.
Kryetari i komitetit drejtues përfaqëson rajonin, drejton bërjen e politikave të komitetit dhe përgjigjet për të, shpall ligjet dhe statutet rajonale, drejton funksionet administrative që shteti ia delegon rajonit, në përputhje me udhëzimet e Qeverisë së Republikës.

**Neni 122**

Sistemi zgjedhor dhe rastet e mosgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë së Kryetarit dhe të anëtarëve të tjerë të Komitetit drejtues rajonal dhe të këshilltarëve rajonalë, do të caktohen me ligjin e rajonit, në përputhje me parimet themelore të përcaktuara me ligjin e Republikës që, po ashtu, përcakton edhe kohëzgjatjen e funksionit të këtyre organeve të zgjedhura.
Askush nuk mund t'i takojë njëkohësisht një Këshillit rajonal ose një Komiteti drejtues rajonal dhe njërës prej dhomave të Parlamentit ose një Këshilli tjetër rajonal ose Parlamentit Evropian.
Këshilli do të zgjedhë një kryetar dhe një sekretar nga anëtarët e vet . Këshilltarët rajonalë nuk mbajnë përgjegjësi për mendimet e shprehura dhe për votat e dhëna gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.
Kryetari i Komitetit drejtues rajonal do të zgjedhet me votim të përgjithshëm dhe të drejtpërdrejtë, përveç nëse statuti rajonal përcakton një mënyrë tjetër të zgjedhjes së tij. Kryetari i zgjedhur në këtë mënyrë mund të emërojë dhe shkarkojë nga puna anëtarët e Komitetit.

**Neni 123**

Çdo rajon ka një statut, që në harmoni me Kushtetutën, përcakton formën e qeverisjes dhe parimet themelore të organizimit dhe funksionimit të rajonit. Statuti rregullon ushtrimin e së drejtës për të marrë nismën e legjislacionit dhe përkrah referendumin për ligjet dhe masat administrative të rajonit dhe botimin e ligjeve dhe rregulloreve rajonale.
Këshilli rajonal aprovon dhe modifikon statutet rajonale, me një ligj të miratuar nga shumica absolute e anëtarëve të vet, me dy votime të mundshme të njëpasnjëshme, brenda një intervali kohor jo më pak se dy muaj.
Ky ligj nuk kërkon pëlqimin e komisionerit të qeverisë. Qeveria e Republikës mund t'ia paraqesë Gjykatës Kushtetuese çështjen e legjitimitetit kushtetues të statuteve rajonale, brenda tridhjetë ditësh, nga dita e publikimit të tyre. Statuti i nënshtrohet një referendumi popullor, kur brenda tre muajsh, nga botimi i tyre në organet zyrtare, këtë e kërkon një e pesëdhjeta e zgjedhësve të rajonit ose një e pesta e anëtarëve të Këshillit rajonal. Statuti që I nënshtrohet referendumit nuk miratohet përfundimisht, nëse nuk aprovohet nga shumica e votave të vlefshme.
Në çdo rajon, statuti rregullon veprimtarinë e Këshillit të autoriteteve vendore si organ këshillëdhënës në marrëdhëniet ndërmjet rajonit dhe autoriteteve vendore.

**Neni 124**

*( i anulluar)*

**Neni 125**

Në rajon do të krijohen Gjykata të shkallës së parë, snë përputhje me regullat e përcaktuara me ligjin e Republikës. Mund të krijohen seksione me seli të ndryshme jashtë kryeqendrës së rajonit.

**Neni 126**

Me dekret të argumentuar të Kryetarit të Republikës, mund të vendoset shpërpërja e Këshillit rajonal dhe largimi i Kryetarit të Komitetit drejtues rajonal nga posti, nëse kanë vepruar në kundërshtim me kushtetutën ose kanë bërë shkelje të rënda ligjore. Shpërbërja dhe heqja nga posti mund të bëhen edhe për shkaqe sigurie kombëtare. Dekreti miratohet pas konsultimit me një Komision deputetësh e senatorësh, që është ngritur për çështjet rajonale në mënyrat e caktuara me ligjin e Republikës.
Këshilli rajonal mund të shprehë votëmosbesim ndaj kryetarit të Komitetit drejtues rajonal nëpërmjet një mocioni të nënshkruar të paktën nga një e pesta e anëtarëve të saj dhe e miratuar me një thirrje nominale të anëtarëve dhe me shumicë absolute.
Mocioni nuk mund të vihet për diskutim para tre ditësh nga prezantimi i tij.Miratimi i mocionit të mosbesimit ndaj kryetarit të Komitetit drejtues rajonal, të zgjedhur me votim të përgjithshëm dhe të drejtpërdrejtë, largimi i tij nga posti, paftësia e vazhdueshme, vdekja ose dorëheqja së vullnetshme e kryetarit të Komitetit drejtues rajonal, sjellin si pasojë dorëheqjen e Komitetit drejtues dhe shpërbërjen e Këshillit. Në çdo rast, të njëjtat pasoja mund të krijohen nga dorëheqja përkohshme e shumicës së anëtarëve të Këshillit.

**Neni 127**

Kur më re se një ligj rajonal i tejkalon kompetencat e rajonit, Qeveria mund t'ia paraqesë për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese legjitimitetin kushtetues të ligjit rajonal në fjalë, brenda gjashtëdhjetë ditësh, nga data e publikimi të tij. Rajoni mund t'ia paraqesë për diskutim Gjykatës Kushtetuese legjitimitetin kushtetues të ligjeve shtetërore dhe rajonale ose të masave ligjore që kanë fuqinë e ligjit,brenda gjashtëdhjetë ditësh, nga data e publikimit të tij, kur më re se ligji ose masa e lartpërmendur i tejkalon kompetencat.

**Neni 128**

*(i anuluar)*

**Neni 129**

*(i anuluar)*

**Neni 130**

*(i anuluar)*

**Neni 131**

Formohen këto rajone:
Piemonti;
Val d'Aosta;
Lombardia;
Trentino-Alto Adixhe;
Veneto;
Friuli-Venecia Xhulia;
Liguria;

Emilia-Romanja;
Toskana;
Umbria;
Marke;
Lacio;
Abruci;
Molize;
Kampania;
Pulja;
Bazilikata;
Kalabria;
Sicilia;
Sardenja.

**Neni 132**

Me ligj kushtetues, pas konsultimit me Këshillat rajonalë, mund të vendoset shkrirja e rajoneve ekzistuese ose krijimi i rajoneve të reja që kanë, të paktën, një milion banorë, kur këtë e kërkojnë shumë Këshilla komunale që përfaqësojnë të paktën një të tretën e popullsive të interesuara dhe kur kërkesa të jetë miratuar me referendum nga shumica e popullatës.

Krahinat dhe komunat që kërkojnë të shkëputen nga një rajon dhe t'i bashkangjiten një rajoni tjetër, mund të lejohen ta bëjnë këtë, me referendum dhe me ligjin e Republikës, me aprovimin e shumicës së banorëve të krahinës ose të krahinave dhe komunave të interesuara, pas konsultimit me këshillat rajonalë.

**Neni 133**

Ndryshimet e kufijve rajonalë dhe krijimi i krahinave të reja brenda rajonit rregullohen me ligje të Republikës, me nismën e komunave, pas konsultimit me rajonin.Rajoni, pasi të kosultohet me popullsitë e interesuara, nëpërmjet ligjeve të veta mund të krijojë komuna të reja në territorin e vet dhe të ndryshojë njësitë dhe emërtimet e tyre.

***Kreu VI***
***Garancitë kushtetuese***
*Pjesa I*
*Gjykata kushtetuese*

**Neni 134**

Gjykata Kushtetuese gjykon: për mosmarrëveshjet në lidhje me ligjitimitetin kushtetues të ligjeve dhe të akteve që kanë vlerën e ligjeve të lëshuara nga shteti dhe nga rajonet; për mosmarrëveshjet që dalin nga kompetencat që i jep shteti dhe nga kompetencat që i kanë shteti dhe rajonet dhe për mosmarrëveshjet ndërmjet rajoneve; për akuzat e ngritura kundër kryetarit të Republikës dhe ministrave, në përputhje me dispozitat kushtetutese.

**Neni 135**

Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 15 gjykatës, një e treta e të cilëve emërohen nga kryetari i Republikes, një e treta nga Parlamenti në seancë të përbashkët dhe një e treta tjetër nga organet e larta të drejtësisë, të zakonshme dhe administrative. Gjykatësit e Gjykatës kushtetuese zgjedhen në mesin e gjykatësve, duke përfshirë edhe pensionistët e gjykatave të larta, të zakonshme dhe administrative, të profesorëve të universitetit të drejtësisë,, avokatëve që kanë të paktën 20 vjet përvojë pune profesionale.

Gjykatësit e Gjykatës kushtetuese emërohen për 9 vjet, duke filluar nga dita e betimit dhe nuk mund të emërohen përsëri.
Në mbarim të afatit merr fund edhe detyra dhe ushtrimi i funksionit të gjykatësit kushtetues.
Gjykata zgjedh kryetarin në mesin e anëtarëve të saj, për një mandat trevjeçar, me undësi rizgjedhjeje, gjithnjë duke respektuar kalimin e afatit për gjykatësit kushtetues.
Funksioni i gjykatësit kushtetues është i papajtueshëm me atë të anëtarit të Parlamentit, të një Këshilli rajonal, me profesionin e avokatit dhe me çdo detyrë a funksion të caktuar me ligj.
Në gjykimin e akuzave të ngritura kundër kryetarit të Republikës dhe kundër ministrave, përvec gjykatësve të rregullt të Gjykatës kushtetuese, marrin pjesë 16 anëtarë të zgjedhur me short nga një listë shtetasish që kanë përgatitje të nevojshme profesionale për t'u zgjedhur në senat, në zgjedhjet të cilat i organizon Parlamenti çdo nëntë vjet, në të cilat zbatohen të njëjtat procedura që janë zbatuar për emërimin e gjykatësve të rregullt.

**Neni 136**

Kur Gjykata e shpall antikushtetues një ligj ose një akt ligjor që ka vlerën e ligjit, atëherë ligji shfuqizohet një ditë pas shpalljes së vendimit. Vendimi i gjykatës botohet dhe u komunikohet dhomave dhe këshillave rajonale përkatëse, në mënyrë që saherë ta konsiderojnë të nevojshme, ata të marrin masa në përputhje me procedurat kushtetuese.

**Neni 137**

Një ligj kushtetues cakton kushtet, format dhe afatet e paraqitjes së vlerësimeve të propozuara lidhur me ligjmërinë kushtetuese dhe garancitë e pavarësisë së gjykatësve të Gjyktatës kushtetuese. Me ligj të zakonshëm vendosen dispozitat e tjera të nevojshme për formimin dhe funksionimin e Gjytatës.
Kundër vendimeve te Gjykatës kushtetuese nuk mund të bëhet ankesë.

*Pjesa II*
*Ndryhimet në Kushtetutë*
*Ligjet kushtetuese*

**Neni 138**

Ligjet për ndryshimin e Kushtetutës dhe të ligjeve të tjera kushtetuese miratohen nga secila dhomë pas dy shqyrtimeve të bëra radhazi në një interval kohor jo më pak se tre muaj dhe me shumicë absolute të anëtarëve të secilës dhomë në votimin e dytë.
Vetë ligjet i nënshtrohen referendumit popullor kur këtë e kërkon një e pesta e anëtarëve të dhomës ose 500.000 zgjedhës ose pesë këshilla rajonale, brenda periudhës tremujore, nga data e botimit të tyre.
Ligji që i nënshtrohet referendumit nuk do të publikohet nëse nuk miratohet me shumicën e votave të vlefshme. Referendumi nuk do të mbahet nëse ligji është miratuar në votrimin e dytë nga secila dhomë, me dy të tretat e shumicës së anëtarëve.

**Neni 139**

Modeli republikan nuk mund të jetë objekt i ndryshimit kushtetues.

## Dispozitat e përkohshme dhe ato përfundimtare

**I**

Me zbatimin e kushtetutës, Kreu i përkohshëm i shtetit do ta ushtrojë funksionin e Kryetarit të Republikës dhe merr përsipër këtë detyrë.

**II**

Nëse në datën e zgjedhjes së kryetarit të Republikës nuk kanë qenë të formuar të gjithë këshillat rajonalë, në zgjedhje do të marrin pjesë vetëm anëtarët e të dyja dhomave të Parlamentit.

**III**

Për përbërjen e parë të Senatit të Republikës do të emërohen senatorë, deputetët e Asamblesë kushtetuese, që zotërojnë cilësi të kërkuara me ligj për të qenë Senatorë dhe që: kanë qenë kryetarë të Këshillit të Ministrave ose të Asambleve legjislative;
që kanë qenë anëtarë të senatit të mëparshëm të shpërndarë; që kanë që të zgjedhur të paktën tre herë, madje edhe në Asamblenë kushtetuese;
që kanë qenë të pushuar në seancën e Dhomës së deputetëve më 9 Nëntor 1926;
që kanë vuajtur dënimin me burg, jo më pak se pesë vjet, sipas vendimit të Gjykatës speciale fasciste për mbrojtjen e shtetit;
Po ashtu, me dekretin e Kryetarit të Republikës, ata që qenë anëtarë të Senatit të të shpërpërë dhe kanë qenë pjesë e Këshillit Kombëtar do të emërohen senatorë.
Nga e drejta për tu emëruar senator mund të hiqet dorë para se të nënshkruhet dekreti i emërimit. Pranimi i kandidaturës në zgjedhjet politike do të thotë heqje dorë nga e drejta për t'u emëruar senator.

**IV**

Për zgjedhjen e parë të Senatit, Molize është konsideruar si rajon në vete, me numrin e nevojshëm të senatorëve në bazë të numrit të banorëve .

**V**

Dispozitat e nenit 80 të Kushtetutës, lidhur me çështjen e marrëveshjeve nërkombëtare që kanë të bëjnë me shpenzimet buxhetore ose me ndryshimet ligjore, do të hyjnë në fuqi në datën e mbledhjes së Parlamentit.

**VI**

Brenda pesë vjetësh pasi Kushtetuta të hyjë në fuqi, vazhdohon rishikimii organeve speciale të jurisdiksionit që ekzistojnë ende, me përjashtim të jurisdiksionit të Këshillit të Shtetit, të Gjykatës së Kontrollit dhe të Gjykatave ushtarake. Brenda një viti nga e njëjta datë, ligji parashikon riorganizimin e Gjykatës supreme ushtarake në bazë të nenit 111.

**VII**

Deri në shpalljen e ligjit të ri mbi organizimin e sistemit të drejtësisë në përputhje me Kushtetutën, do të zbatohen dispozitat në fuqi.
Deri sa Gjykata kushtetuese të fillojë funksionin e vet, vendimet mbi çështjet kundërthënëse të paraqitura në nenin 134, do të merren në format dhe brenda kufijve të dispozitave që tashmë ekzistonin para se të hyjë në fuqi Kushtetuta.
Shënim: Neni 7 i ligjit kushtetues i 22 Nëntorit 1967, nr .2, ka anulluar paragrafin e fundit të vendimit, që citonte si vijon: "Gjykatësit e Gjykatës kushtetuese të emëruar në përbërjen e parë të Gjykatës nuk janë të nënshtruar në rinovimin parcial dhe rrinë në detyrë dymbëdhjetë vjet" .

**VIII**

Zgjedhjet e Këshillave rajonalë dhe të organeve të zgjedhura të administratës rajonale do të organizohen brenda një viti, nga hyrja në fuqi e Kushtetutës.
Për çdo degë të administratës publike, ligjet e Republikës rregullojnë kalimin e funksioneve shtetërore që u takojnë rajoneve.
Deri sa të përfundojë riorganizimi dhe rishpërndarja e funksioneve administrative midis organeve vendore, krahinat dhe komunat do t'i ruajnë ato funksione që i ushtrojnë tani dhe funksionet e tjera që rajonet mund t'ua japin atyre.
Ligjet e Republikës rregullojnë kalimin e funksionarëve dhe nëpunësve shtetëror në rajone, duke përfshirëe dhe ata të administratave qendrore që, sipas dispozitave të reja, janë të nevojshëm.
Për formimin e zyrave të tyre,rajonet do ta caktojnë listën e personelit nga nëpunësit e organeve shtetërore vendore.

**IX**

Brenda tre vjetëve pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, Republika do t'i harmonizojë ligjet e saj me nevojat e autonomive vendore dhe me kompetencat legjislative që u janë dhënë rajoneve.

**X**

Për rajonin e Friuli-Venecia Xhulias, sipasnenit 116, zbatohen përkohësisht dispozitat e përgjithshme të Kreut të V, pjesa e dytë, pa paragjykuar e pakicat gjuhësore, në përputhje me nenin 6.

**XI**

Sipas ligjeve kushtetuese, deri pesë vjet pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, mund të formohen rajone të tjera, duke ndryshuar kështu listën në nenin 131, edhe pa kushtet që kërkohen nga paragrafi i parë i nenin 132, megjithatë, pa paragjykuar detyrimin për të dëgjuar mendimin e njerëzve të interesuar.
Shënim: Afati i vendimit që citohet në këtë nen është shtyrë në datën 31 Dhjetor1963 me ligjin kushtetues të 18 Marsit 1958, nr. 1.

**XII**

Ndalohet çfarëdo forme e riorganizimit të partisë fashiste të mëparshme.
Pavarësisht nga neni 48, për përgjegjësit e regjimit fashist, ligji ka vendosur kufizime të përkohshme të së drejtës së votimit dhe të zgjedhshmërisë, për jo më shumë se pesë vjet, nga hyrja në fuqi e Kushtetutës.

**XIII**

Anëtarët dhe pasardhësit e Shtëpisë mbretërore Savoja nuk do të jenë zgjedhësdhe nuk do të mbajnë poste publike as funsione të zgjedhura. Ish mbretërve të Shtëpisë mbretërore Savoja, bashkëshortëve të tyre dhepasardhësve të tyre meshkuj, u është ndaluar hyrja dhe qëndrimi në territorin kombëtar. Pasuria e ish mbretërve të Shtëpisë Savoja, të bashkëshortëve të tyre dhe të pasardhësve të tyre meshkuj, që ekziston në territorin kombëtar, do t'i kthehet shtetit.
Bartja dhe vendosja e të drejtave mbretërore mbi pasurinë e lartpërmendur, që janë bërë pas datës 02 Qershor 1946, do të anulohen dhe shfuqizohen. Shënim: Ligji kushtetues i 23 Tetorit 2002, nr.1, ka vendosur që paragrafi i parë dhe i dytë i nenit XIII "vendim i përkohshëm dhe përfundimtar" të Kushtetutës, janë të pavlefshëm duke filluar nga data e hrjes në fuqi të të njëjtit ligj kushtetues (10Nëntor 2002).

**XIV**

Titujt e shtresës fisnike nuk do të njihen. Kallëzuesit e titujve që kanë ekzistuar para datës 28 Tetor 1922, vlejnë si pjesë e emrit. Urdhëri i Mauricianit të Shenjtë do të konservohet si ent spitalor dhe do të funksionojë në mënyrat e përcaktuara nga ligji.
Me ligj do të rregullohet ndalimi i punës së Këshillit Heraldik.

**XV**

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës, dekreti legjislativ Nr. 151 i datës 25 qershor 1944, mbi organizimin e përkohshëm të shtetit, do të kthehet në ligj.

**XVI**

Brenda një viti, nga data e hyrjes në fuqi e Kushtetutës, do të fillojë rishikimi dhe bashkërendimi i ligjeve paraprake kushtetuese që deri më tani nuk janë shfuqizuar qartë ose plotësisht.

**XVII**

Asambleja Kushtetuese do të thirret nga kryetari i saj për të vendosur, para 31 Janarit 1948, për ligjin e zgjedhjeve për Senatin e Republikës, për statutet speciale rajonale dhe për ligjin mbi shtypin.
Deri në ditën e zgjedhjeve të dhomave të reja, Asambleja Kushtetuese mund të thirret kur të ketë nevojë për të vendosur në lëndët që i takojnë kompetencave të saj nga neni 2, paragrafi i pare dhe i dytë, dhe neni 3, paragrafi I parë dhe i dytë, të dekretit legjislativ të 16 Marsit 1946, nr. 98. Në këtë periudhë, komisionet e përhershme do t'i mbajnë funksionet e tyre, ndërsa komisionet legjislative ia dorëzojnë qeverisë projektligjet, me vërejtje dhe propozime për ndryshime.
Deputetët mund t'i bëjnëpyetje Qeverisë me kërkesëpër përgjigje me shkrim. Në përputhje me paragrafin e dytë të këtij neni, Asambleja Kushtetuese, do të thirret nga kryetari i saj, me kërkesë të arsyetuar të Qeverisë ose, të paktën, nga dyqind deputetë.

**XVIII**

Kushtetuta e tanishme do të shpallet nga Kryetari i përkohshëm i shtetit, brenda pesë ditësh nga aprovimi i saj nga ana e Asamblesë Kushtetuese dhe do të hyjë në fuqi më 01 Janar 1948. Teksti i Kushtetutës do të vendoset në sallën komunale të secilës komunë të Republikës për të qënë i ekspozuar gjatë gjithë vitit 1948, me qëllim që çdo qytetar të ketë njohuri për të. Kushtetuta, e pajisur me vulën e shtetit, do të futet në Regjistrat zyrtarë të ligjeve dhe të dekreteve të Republikës.
Kushtetuta, siligj themelor i Republikës,duhet të zbatohet me besnikëri, nga të gjithë qytetarët dhe nga organet e Shtetit.

Enrico De Nicola

Umberto Terracini

Alcide De Gasperi